VENDIM
Nr.632, datë 24.12.1999

PËR SHTESË FONDESH PËR INVESTIME PËR VITIN 1999

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Punëve Publike, në buxhetin e miratuar për investime, për vitin 1999, i shtohen 20 milionë lekë, për objektin "Sistemim asfalsim në rrugën "Ali Demi", për bashkinë e Tiranës.

2.Shuma prje 20 milionë lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike dhe bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta